

VENDIM
Nr.397, datë 11.7.2007

PËR NJË PËRJASHTIM NGA VENDIMI NR.244, DATË 7.3.2007 I KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE NË MINISTRITË DHE
INSTITUCIONET QENDRORE, PËR VITIN 2007”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfshihet për Akademinë e Shkencave afatet “janar - 31 maj” dhe “1 qershor - dhjetor”, të përcaktuara në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet vendimit nr.244, datë 7.3.2007 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve në ministritë dhe institucionet qendrore, për vitin 2007”, të ndryshuar, bëhen “janar – 31 gusht” dhe “1 shtator - dhjetor”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Akademia e Shkencave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha